



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 191, Datë 28/12/2016

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 98, datë 03.10.2016, e bërë nga z. [Emri i fshehtë], kundër shkollës së mesme profesionale “Sali Ceka”<sup>2</sup>, Elbasan në të cilën pretendimet për diskriminim për shkak të “etnisë”<sup>3</sup> dhe “gjendjes ekonomike”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Subjekti ankues deklaroi se: *“Sipas legjislacionit në fuqi fëmijët e komunitetit egjiptian përfitojnë tekstet shkollë falas, por ky vendim nuk po zbatohet nga drejtorja e shkollës e cila shprehet se fillimisht prindërit duhet të blejnë librat dhe më pas do të rimbursohen. Z. informon se në situatën ekonomike që familja e tij ndodhet e ka të pamundur që të blejë librat për djalin e tij në klasë të XII-të, sepse të ardhurat e tija janë të kufizuara pasi trajtohet vetëm me ndihmë ekonomike në shumën 5.200 lek”.*

Ankesa e z. [Emri i fshehtë] është mbështetur nga shoqata “Lëvizja Rinore – Egjiptiane & Rome e Shqipërisë” e cila ka asistuar z. [Emri i fshehtë] që ti drejtohet zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në nenin I të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike,*

<sup>1</sup> Në cilësinë e prindit të nxënësit [Emri i fshehtë]

<sup>2</sup> Referuar formularit të ankesës z. [Emri i fshehtë] është ankuar gabimisht ndaj shkollës “Ali Myftiu”.

<sup>3</sup> Z. [Emri i fshehtë] i përket komunitetit Egjiptian të qytetit të Elbasanit.

*gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Rekomandimi Nr. 7, i ECRI<sup>4</sup>- it (2003)<sup>8</sup> shpreh se: “*diskriminimi racial i drejtpërdrejtë*”, do të thotë çdo trajtim i ndryshëm i bazuar në shkaqe si: *raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia, ose origjina etnike ose kombëtare, të cilat nuk kanë një përlligje të arsyeshme dhe objektive. Trajtimi i ndryshëm nuk ka përlligje të arsyeshme dhe objektive nëse nuk ndjek një qëllim të ligjshëm ose nëse nuk ka një marrëdhënie proporcionale të arsyeshme midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit të njohur për t’u realizuar*<sup>5</sup>”.

Në vijim të trajtimit të ankesës, Komisioneri, do t’i referohet diskriminimit për shkak të etnisë, bazuar në kuptimin e mësipërm të diskriminimit racial.

Etnia, është shkak për të cilin ligji nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje dhe bazuar në nenin 32/1/c të këtij ligji, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkelje, që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me racën.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 3 të tij, përcakton: “Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Ligji 10221/2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’ në nenin 17/4 sanksionon se: “Zbatimi i masave të posaçme dhe të përkohshme, bazuar në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, me qëllim përshpejtimin e barazisë në arsim, nuk konsiderohet diskriminim. ....”.

*Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:*

- Me shkresën Nr. 922 prot, datë 05.10.2016 u njoftua dhe ju kërkua informacion shkollës “Ali Myftiu” Elbasan, duke e vënë në dijeni për fillimin e procedurave të shqyrtimit të ankesës si dhe duke i kërkuar informacion mbi pretendimin e subjektit ankues.

Me shkresën nr. 159 Prot, datë 20.10.2016 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Drejtoria e shkollës “Ali Myftiu” Elbasan informon se, djali i : [emri i fëmijës] nuk është nxënës i shkollës profesionale “Ali Myftiu” por ndodhet në shkollën “Sali Ceka”.

<sup>4</sup> Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës. ECRI.

<sup>5</sup> Referuar Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës. ECRI

- Me shkresën Nr. 912/2 prot, datë 28.10.2016 u njoftua dhe ju kërkua informacion shkollës “Sali Ceka” Elbasan, duke e vënë në dijeni për fillimin e procedurave të shqyrtimit të ankesës si dhe duke i kërkuar informacion mbi pretendimin e subjektit ankues.

Me shkresën nr. 51/1, datë 03.11.2016 të dërguar me e-mail në datë 01.12.2016, pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Drejtoria e shkollës “Sali Ceka” Elbasan informon se: *“Nxënësi i klasës së XII, është pajisur me tekste shkollore të përdorura dhe të reja pjesërisht nga biblioteka e shkollës për shkak të mungesës së teksteve. Krahas teksteve të kulturës së përgjithshme nxënësi është pajisur dhe me tekstet e kulturës profesionale. Procesi i pajisjes me libra ka përfunduar që në datë 07.11.2016”.*

**Bazuar në faktet e mësipërme dhe në analizë të legjislacionit në fuqi, Komisioneri vlerëson se:**

Ekziston një legjislacion dhe akte nënligjore, politika dhe strategji, ku parashikohen detyrime për të gjithë institucionet e përfshira në procesin e arsimimit.

Në nenin 18, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, “Detyrat e Këshillit të Ministrave dhe të Ministrit të Arsimit dhe Sportit”, në pikën 2/c, parashikon se: “Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Arsimit dhe Sportit, ndër të tjera, marrin secili masa për: ...c) arsimimin e të gjithë popullsisë, në mënyrë të veçantë, duke marrë masa në favor të grave dhe vajzave, pakicave, personave me aftësi të kufizuar, si dhe të personave që janë, ose kanë më shumë mundësi të jenë objekt i diskriminimit, për shkaqet e përmendura në nenin 1, të këtij ligji.”

Në VKM 911, datë 11.11.2015 “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e pagesave dhe për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, për nxënësit e studentët në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2015-2016”, pika 9.3, parashikon se: “Nxënësit e komunitetit rom dhe egjiptian, që vazhdojnë studimet në shkollat e mesme profesionale, përfitojnë falas, veshmbathje, libra dhe fletore sipas pasqyrës nr.6”.

Nxënësit romë dhe egjiptianë janë subjekte të një akti nënligjor, që mundëson përfitimin e teksteve shkollore falas, me ndihmën dhe financimin e shtetit, kryesisht për faktin se familjet rome dhe egjiptiane, sikurse edhe familjet e kategorive të tjera, të parashikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave të sipërpërmendur, ndodhen në vështirësi ekonomike dhe nuk mundën të përballojnë financiarisht, në mënyrë të pavarur, blerjen e teksteve shkollore për fëmijët e tyre.

Referuar nenit 2/b/a të Udhëzimit të Përbashkët nr. 16, datë 03.08.2016 “Për vitin shkollor 2016-2017 në sistemin arsimor parauniversitar” në të cilën është vendosur se procesi mësimor në arsimin profesional fillon më datë 13.09.2016 si dhe referuar shkresës nr. 51/1, datë 03.11.2016 të dërguar nga shkolla “S.Ceka”, në të cilën informon se procesi i pajisjes me tekste shkollore falas për nxënësin L.Ostaj ka përfunduar me datë 07.11.2016, Komisioneri vlerëson se për vetë rëndësinë që ka arsimimi i komunitetit rom dhe egjiptian, drejtoria e shkollës “Sali Ceka”

**duhet të kishte marrë masat për të pajisur nxënësit me tekste shkollore falas që në ditët e para të fillimit të vitit shkollor.**

Në bazë të ligjit 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" në nenin 3, pika 1, diskriminimi përkufizohet si: "çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi".

Ligji 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", në nenin 3, pika 2, parashikon se: "Diskriminimi i drejtpërdrejtë" është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji".

Referuar fakteve të sipërcituara, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vlerëson se: Ka ekzistuar një situatë diskriminuese ndaj nxënësit të klasës së XII, i cili, për shkak se atij i është krijuar mundësia e pajisjes me tekste shkollore, tetë javë pasi kishte filluar procesi mësimor gjë që krijon mundësinë e ndikimit në përvetësimin e njohurive sipas planit mësimor. Në këto kushte drejtoria e shkollës "Sali Ceka" duhet të kishte marrë masat që vonesa në pajisjen e nxënësve që përfitonin nga zbatimi i VKM-s 911, datë 11.11.2015 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e pagesave dhe për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, për nxënësit e studentët në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2015-2016", të ishte shmangur dhe pajisja me tekste të ishte kryer brenda një afati dy-tri javor nga fillimi i vitit shkollor.

Bazuar në shkresën nr. 51/1, datë 03.11.2016 të dërguar nga drejtoria e shkollës "Sali Ceka" Elbasan në të cilën informon, se në datë 07.11.2016 drejtoria e shkollës "S.Ceka" ka pajisur me tekste shkollore falas nxënësin ... Komisioneri vlerëson se u arrit qëllimi për të cilin është nisur ky hetim në drejtim të pajisjes me tekste shkollore falas të fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian.

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, geramat a) dhe c), nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## VENDOSI:

1. Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë të z. L. Ostaj, nga ana e Drejtorisë së shkollës së mesme profesionale "Sali Ceka, Elbasan.
2. Ndërprerjen e procedurave të hetimit dhe pushimin e çështjes për z. L. Ostaj, pasi u arrit dhe qëllimi për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
3. Rekomandohet që për vitin e ardhshëm shkollor Drejtoria e shkollës së mesme profesionale "Sali Ceka, Elbasan që në fillim të vitit shkollor të marrë masat për pajisjen e nxënësve të komunitetit rom dhe egjiptian me tekste mësimore.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në gjykatë, brenda afateve ligjore.

